



BD - Präsidiabereich

**HR Mag. Dr. Eva Hofbauer, MBA**  
Präsidialleitung

[office@bildung-sbg.gv.at](mailto:office@bildung-sbg.gv.at)  
+43 662 8083-1052  
Mozartplatz 8 - 10, 5010 Salzburg

Antwortschreiben bitte unter Anführung der Geschäftszahl.

Geschäftszahl: 580014/0334-PA-Stab/2020

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte),

Pandemia e virusit korona po na vë të gjithëve para sfidash të mëdha. Qëllimi është që të mund ta mbajmë në fuqi funksionimin normal të shkollës. Mirëpo pandemia e Covid-19 për fat të keq nuk po bën pushim. Me këtë vazhdon të jetë e lidhur edhe lutja ndaj jush, për të ndihmuar që të ndalohet sa më shumë që të jetë e mundur përhapja e virusit. Këtu bën pjesë edhe mosdërgimi i fëmijëve në shkollë, kur shfaqin simptoma, dhe pajisja e tyre - prej moshës gjashtë vjeç - me mbrojtjen përkatëse të gojës dhe hundës kur shkojnë në shkollë.

Deri tani një fëmijë me simptomat tipike të COVID-19 vlerësohej në shkollë si një rast i dyshuar. Drejtoria e shkollës ishte e detyruar të informonte Seksionin e Shëndetësisë, i cili zakonisht urdhëronte që të bëhej një test (PCR-) i koronës, për kryerjen dhe rezultatin e të cilit duhej të prisje. Shpesh kjo shoqërohej në shkollë me shumë shqetësim: prindërit duhet të rrinin bashkë me fëmijën në shtëpi dhe të prisnin për një test, mësuesit dhe mësueset izoloheshin dhe nuk mund të jepnin mësim edhe kur fëmija nuk ishte pozitiv.

**Tani ka një zgjidhje në vend të këtij shqetësimi dhe pasigurisë nëse një fëmijë është i sëmurë me COVID-19 ose jo.**

- Ministria për Arsimin, Shkencën dhe Hulumtimin Shkencor (BMBWF) do të verë në dispozicion për shkollat austriake teste antigen të shpejta.
- Këto nuk kanë nevojë të përpunohen në laborator. Rezultati del pas 15 deri 30 minutash.
- Këto teste janë një mënyrë shumë inovative dhe e parrezikshme për të sqaruar simptomat që shfaqen te nxënëset dhe nxënësit, si dhe te personeli në shkollat tona.

Prandaj, me këtë letër dëshiroj t'ju jap mundësinë që ta shfrytëzoni këtë shërbim dhe të jepni miratimin tuaj për zbatimin e testit të shpejtë antigen të fëmija tuaj. Nëqoftëse fëmija juaj është mbi 14 vjeç, ai mund ta japë vetë pëlqimin. Pjesëmarrja është vullnetare, kuptohet, askush nuk është i detyruar që ta bëjë këtë test. Veç kësaj, ne gjithmonë do t'ju kontaktojmë para se ta çojmë fëmijën

tuaj për t'u testuar, me qëllim që të bisedojmë me ju për situatën tuaj individuale dhe të sqarojmë gjithashtu nëse mund të vini në kohën e duhur në shkollë, në rast se doni ta bëni testin. Është e mundur gjithashtu që ta tërhiqni pëlqimin tuaj. Nëse nuk doni ta jepni miratimin tuaj, në rast se ka simptoma të dyshimta drejtorja e shkollës është e detyruar të informojë Seksionin e Shëndetësisë, i cili vendos pastaj për masat e mëtejshme.

**Vënia në përdorim e testeve të shpejta është një shans i madhe për të gjithë ne, që të mund ta mbajmë sa më mirë në fuqi funksionimin e shkollës.**

**Në fund një lutje që duhet ta keni gjithmonë parasysh: edhe në të ardhmen mos e dërgoni fëmijën tuaj në shkollë, kur shfaq shenja se është i sëmurë.**

Për informata të mëtejshme shikoni materialin bashkangjitur kësaj letre dhe informacionet zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Hulumtimit Shkencor: [www.bmbwf.gv.at/antigentests](http://www.bmbwf.gv.at/antigentests).

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj,

Salzburg, 03.12.2020

HR Mag. Dr. Eva Hofbauer, MBA

## **Deklaratë miratimi për kryerjen e një testi të shpejtë antigen në një rast të dyshuar për COVID-19 në shkollë**

Një test i shpejtë antigen mund të kryhet vetëm atëhere kur personi që do të testohet - respektivisht personi me të drejtë kujdestarie për fëmijët e moshës shkollore deri në moshën 14 vjeç - jep miratimin. Ky miratim vlen për testin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me testin dhe rezultatin e tij.

Informacione të tjera për kryerjen e testit përfshihen në një letër që i bashkangjitet kësaj deklaratë. Kjo letër, me gjithë materialin që i është bashkangjitur, përbën bazën e Deklaratës së Miratimit. Një tërheqje, anulim i Deklaratës së Miratimit është i mundur në çdo kohë dhe vlen për të ardhmen (me postë, e-mail ose faks që i drejtohet shkollës). Duke e anuluar Deklaratën e Miratimit nuk preket legjitimiteti i masave dhe përpunimit të të dhënave që janë ndërmarrë më bazë të miratimit. Një anulim nuk ka të bëjë me kryerjen e testeve nga ana e Seksionit të Shëndetësisë.

Emri dhe mbiemri i personit që do të testohet:

Adresa e shtëpisë:

Numri i telefonit /Adresa e e-mailit

(e personit me të drejtë kujdestarie) për ta njoftuar rreth rezulttit:

Unë

- e miratoj,
- nuk e miratoj,

që në rast dyshimi për një sëmundje me COVID-19 të bëhet te unë ose te fëmija im nën moshën 14 vjeç një marrje prove në hundë dhe fyt (nëpërmjet fytit ose hundës) prej personelit të shkolluar.

\_\_\_\_\_  
Vendi data

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i personit që do të testohet prej moshës 14 vjeç ose e përfaqësuesit ose përfaqësueses ligjore

\_\_\_\_\_  
Emri (me gërma shkrimi)

*ANLAGE bashkangjitur: Informacione të mëtejshme*

### **Çfarë ndodh kur dyshohet për një rast?**

Në rast të një dyshimi gjithmonë lajmërohet fillimisht personi me të drejtë kujdestarie. Drejtoria ka në dispozicion për këtë rast të dhënat kontaktuese („Lajmërohet në rast urgjence.“) dhe vendos me këtë person se si do të vepohet më tej.

- a) Nëse ekziston një Deklaratë Miratimi për një test të shpejtë antigen, njoftohet Skuadra Lëvizëse. Personi me të drejtë kujdestarie paraqitet brenda një ore në shkollë dhe pret së bashku me fëmijën për testin. Kur është vendosur ndryshe, mundet që fëmija ta kryejë testin edhe pa personin me të drejtë kujdestarie. Nëse personi me të drejtë kujdestarie nuk ka mundësi që të vijë në shkollë brenda një ore, Deklarata e Miratimit mund të anulohet.
- b) Nëse nuk ka një Deklaratë Miratimi, personi me të drejtë kujdestarie është i lutur që ta marrë sa më parë fëmijën nga shkolla ose të dërgojë dikë tjetër për këtë gjë. Drejtoria e shkollës është e detyruar pas kësaj sipas Ligjit të Epidemisë që të njoftojë Seksionin e Shëndetësisë dhe të vërë në funksionim zinxhirin e veprimeve sipas udhëzimeve për higjenën, parandalimin dhe procedurën gjatë COVID-19.
- c) Nëse nuk ka një deklaratë miratimi, mund të bihet dakord me anë të telefonit midis drejtorisë së shkollës dhe personit me të drejtë kujdestarie, që testi të kryhet megjithatë. Në këtë rast Deklarata e Miratimit mund të nënshkruhet edhe në vend. Personi me të drejtë kujdestarie duhet në këtë rast që të vijë në shkollë brenda një ore.

### **Kush e teston fëmijën tim?**

Në landin tonë do të jenë në dispozicion duke filluar prej datës 07.12.2020 skuadra mobile testimi për kryerjen e testeve të shpejta nëpër shkolla. Këto do të koordinohen nga një qendër drejtuese në Kryqin e Kuq. Këto teste do të kryhen gjithmonë nga një personel mjekësor i specializuar. Testi është i ndjeshëm dhe bëhet nëpërmjet një marrje prove nga hunda dhe fyti, që realizohet nëpërmjet fytit ose hundës. Po të ketë një mjeke ose mjek shkollë në dispozicion në shkollë, testin mund ta bëjë edhe ai.

### **Kur do të testohet fëmija im?**

Kur një mësueseje ose një mësuesi i bie në sy që fëmija juaj nuk e ndien veten mirë dhe simptomat sipas drejtorisë së shkollës mund të kenë lidhje me një infektim me COVID-19. Te fëmijët nën 10 vjeç këtë e tregon sidomos temperatura mbi 38°. Te fëmijët mbi 10 vjeç simptomat janë kollë, dhimbje fyti, vështirësi në frymëmarrje ose humbje e papritur e shqisës së nuhatjes ose shijes, simptoma që mund të shoqërohen me temperaturë. Ne u përmbahemi në këtë rast rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

### **Çfarë ndodh pasi del rezultati i testit?**

Në shumicën e rasteve një rezultat negativ mund t'i japë fund shpejt alarmit. Megjithatë ju lutemi që ta merrni fëmijën tuaj nga shkolla, kur ai nuk ndihet mirë. Vetëm në rast të një rezultati pozitiv drejtoria e shkollës kontakton Seksionin e Shëndetësisë dhe vë në funksionim zinxhirin e veprimeve sipas udhëzimeve për higjenën, parandalimin dhe procedurën gjatë COVID-19.